VENDIM
Nr. 169, datë 15.5.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 107, DATË 23.3.2023, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË'ATEANI ENERGY' SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET 'SHUTRI 1' ME KAPACITET TË INSTALUAR 370 kw DHE 'SHUTRI 2', ME KAPACITET 1600 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 1970" kw

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 22/19 prot., datë 12.5.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.3.2023, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Ateani Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet 'Shutri 1' me kapacitet të instaluar 370 kw dhe 'Shutri 2' me kapacitet 1600 kw, me kapacitet të instaluar 1970 kw",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 107, datë 23.3.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë "Ateani Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet "Shutri 1" me kapacitet të instaluar 370 kw dhe "Shutri 2", me kapacitet 1600 kw, me kapacitet total të instaluar 1970 kw, për një afat 29 vjet e 2 muaj, duke i lënë kusht që të informojë çdo 2 (dy) muaj në ERE mbi ecurinë e marrjes së Lejes për përdorimin e burimit ujor me afat të saktësuar dhe ta depozitojë atë në ERE jo më vonë se data 25.07.2023.
- Në lidhje me këtë kusht dhe brenda afatit të përcaktuar në vendim, shoqëria ka depozituar vendimin e Këshillit të Basenit Ujor Mat me nr. 13, datë 28.3.2023, si dhe lejen për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor me nr. 17 prot, datë 4.4.2023, ku përcaktohet se periudha e vlefshmërisë së saj është sipas kontratës së koncesionit.
- Sa më sipër, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit nr. 107/2023, me plotësimin e të cilit nuk gjen më zbatim as pika 3, ndaj vlerësohet të shfuqizohen.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 dhe pika 3 e vendimit te Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.3.2023, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë "Ateani Energy" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti